



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:231742
Datë: 16.06.2022
Numri i dokumentit: 03141730

C.nr.1021/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Divizioni Civil, gjyqtari **Betim Behluli**, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qmega, në çështjen juridike të paditësit B. G. nga fshati Zoqisht, Komuna e Rahovecit, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar Av. A. M., sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurit A. M. nga fshati Nabërgjan, Komuna e Pejës, për shkak të pasurimit të pabazë, vlera e kontestit **10,200.00 Euro**, pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit kryesor, dhe zbatimit të provave, më **02.06.2022**, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit **B. G.** nga fshati Zoqisht, Komuna e Rahovecit, si në vijim:
- II. OBLIGOHET** i padituri **A. M.** nga fshati Nabërgjan, Komuna e Pejës, që në emër të pasurimit të pabazë, paditësit t’ia kompensoj shumën në lartësi prej 10,200.00 €, e në emër të detyrimit të dalur nga kontrata interne mbi shitblerjen e një traktori të markës “Hurlimann” H-490 A, me numër të shasisë A207 00 122 nr. i trungut 063.659.812, me targa AG339, me ngjyrë jeshile gri, një frez për traktor dhe një plug rrotullues me çmimin kushtues në shumë prej 10,000.00 €, me kamatë prej 8 %, e cila do të llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë respektivisht nga data 14.10.2021, dhe atë në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.
- III. APROVOHET** propozimi i propozuesit të masës së sigurimit, B. G. dhe **LEJOHET** masa e sigurimit, në atë mënyrë që të paditurit A. M., i ndalohet tjetërsimi apo fshehja e një traktori të markës “Hurlimann” H-490 A, me numër të shasisë A207 00 122 nr. i trungut 063.659.812, me targa AG339, me ngjyrë jeshile gri, një frez për traktor dhe një plug rrotullues, deri në vendosjen meritore të çështjes kontestimore, përkatësisht deri në përmbushjen e detyrimit sipas kontratës interne mbi shitblerje.
- IV. OBLIGOHET** i padituri që paditësit ti paguan shpenzimet procedurale në shumë prej **339,00 Euro**, po ashtu në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor është mbajtur në mungesë të palës së paditur, në kuptim të nenit 423 parag. 4 të LPK-së.

Paditësi B. G., nëpërmjet përfaqësuesit të tij të autorizuar, ka ushtruar padi kundër të paditurit A. M., për shkak të pasurimit të pabazë.

I padituri me parashtresën e tij përgjigje në padi prej datës 21.12.2021, e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit.

Sipas kësaj çështje juridike janë caktuar disa seanca e shqyrtimi kryesor radhazi, në të cilën janë paraqitur përfaqësuesi i autorizuar i paditësit Av. A. M., ndërsa për të paditurin A. M., askush, për të cilin gjykata ka prova se është ftuar në mënyrë të rregullt, por mungesën e vet nuk e ka arsyetuar.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit Av. A. M. ka deklaruar se ngel pranë padisë dhe kërkesëpadisë, palët në procedurë pranë Av. F. H., me datën 06.05.2021, kanë lidhur kontratën me shkrim, në lidhje shitblerjen e traktorit të markës “Hurlimann” H-490 A, me të dhënat e cekura sikurse në padi ku paditësi që në momentin e lidhjes së kontratës së përmendur, e ka përmbushur detyrimin kontraktuale, në atë që i padituri A. M. ia ka shfrytëzuar në shfrytëzim dhe posedim traktorin e shitur, një freze për traktor dhe një fluge, ndërsa i padituri është dashtë që përfundimisht të datës 03.07.2021, ti paguaj paditësit 10,200.00 €. Edhe për kundër faktit se i padituri nuk e ka përmbushur detyrimin kontraktues, paditësi me një parashtresë të veçantë me shkrim, prej datës 21.06.2021 të paditurit i ka dërguar vërejtjen para ushtrimit të padisë, duke i dhënë afat shtesë prej 15 ditëve që ta përmbush detyrimin në mënyrë vullnetare.

Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se gjykata me prova formale – juridike e sidomos nga kontrata mbi shitblerje të lidhur pranë Av. F. H., nga deklarata e dëshmitarëve A. G. dhe F. G. ka konstatuar faktin relevant se mes palëve në procedurë është lidhur kontrata formale mbi shitblerjen e traktorit me të dhëna sikurse në padi, një frez traktori, si dhe plugu rrotullues e gjykata po ashtu ka vërtetuar faktin me rëndësi se i padituri A. M. nuk e ka përmbushur detyrimin kontraktuale dhe nuk i ka derdhur mjetet në shumë prej 10,000.00 €, në llogarinë e paditësit, andaj i propozoi gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta miratoj në tërësi si me bazë dhe njëherit ta miratoj edhe masën siguroese dhe të paditurit A. M. t’ia ndal tjetërsimin apo fshehjen e traktorit me të dhënat sikurse në padi, frezit të traktorit dhe plugut rrotullues. Shpenzimet e procedurës i kërkoi sipas tarifave të Odës së Avokatëve.

Për të vërtetuar faktet vendimtare në lidhje me këtë çështje kontestimore, gjykata i ka zbatuar këto provat: ka bërë shikimin në kontratën për shitblerjen e traktorit të datës 06.05.2021 e lidhur në mes B. G.t dhe A. M., ka bërë shikimin në librezën e pronësisë së traktorit, ka bërë shikimin në vërejtjen për përmbushje të detyrimit, si dhe në cilësi të dëshmitarëve janë dëgjuar A. H. G. dhe F. A. G. të dytë nga fshati Zoqishtë, Komuna e Rahovecit.

Pas analizimit dhe vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, bazuar në dispozitat të neneve 7 dhe 8 të LPK-së, duke i vlerësuar deklaratimet e ndërgjyqësve dhe në bazë të bindjes së vetë të lirë, është konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe të njëjtën e ka aprovuar.

Me shikimin në kontratën për shitblerjen e traktorit të datës 06.05.2021 e lidhur në mes B. G.t dhe A. M., vërtetohet se paditësi me të paditurin kanë lidhur kontratë për shitblerjen e traktorit dhe shtojcat të traktorit, në shumë prej 10,200.00 €, me kushtet e pagesës sipas specifikimit në marrëveshje.

Me shikimin në librezën e pronësisë së traktorit, vërtetohen shënimet e traktorit si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me shikimin në vërejtjen drejtuar të paditurit A. M. i është tërhequr vërejtja që se nuk është paguar borxhi.

Dëshmitari A. H. G., pasi që iu është tërhequr vërejtja që të deklaroj të vërtetën dhe gjithë atë që din lidhur me çështjen kontestimore dhe pasi që është njoftuar me pasojat e deklarimit të rrem i njëjti ka deklaruar se: ka qenë prezent në zyrën e avokatit F. H. kur këtu palët në procedurën kanë lidhur kontratën me shkrim mbi shitblerjen e traktorit të përshkruar sikurse në padi, një freze dhe një plug rrotullues. E di fare mirë se këtu paditësi B. G. në ditën e lidhjes së kontratës mbi shitblerje e ka përmbushur detyrimin e vet kontraktues, në atë mënyrë që këtu të paditurit A. M. ia ka dorëzuar në shfrytëzim dhe posedim traktorin, frezim dhe plugun rrotullues, ndërsa i padituri ka marr për detyrimin që përfundimisht me datën 03.07.2021 që ne xhirollogarinë e paditësit pranë R. Bank, ti derdh mjetet ne shume prej 10.200,00 euro. Edhe për kundër saj i padituri A. M. as sot e kësaj dite nuk i ka paguar borxhin në shumë prej 10.200,00 euro këtu paditësit B. G..

Dëshmitari F. A. G., pasi që iu është tërhequr vërejtja që të deklaroj të vërtetën dhe gjithë atë që din lidhur me çështjen kontestimore dhe pasi që është njoftuar me pasojat e deklarimit të rrem i njëjti ka deklaruar se: e ka të njohur faktin se këtu palët në procedurë e pranë avokatit F. H. me datë 06.05.2021, ka lidhur kontratën me shkrim mbi shitblerjen e një traktori me të dhënat sikurse në padi, një freze traktori dhe një plug rrotullues për çmim të përgjithshëm prej 10,200.00 euro. Po ashtu e ka të njohur faktin këtu paditësi B. G. ka përmbushur detyrimin kontraktuale në atë mënyrë që këtu të paditurit A. M. ia ka dorëzuar në shfrytëzim dhe posedim të lirë traktorin, frezin për traktor dhe plugun rrotullues ndërsa i padituri është dashtë ta përmbush detyrën e vet në atë mënyrë në shumën prej 10,200.00 euro, ti derdh ne llogarinë bankare te paditësit me datën 03.07.2021, mirëpo i padituri as sot e kësaj dite, nuk e ka përmbush detyrimin kontraktuale.

Me nenin 8 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është paraparë se *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”*, ndërsa me nenin 245 të po këtij ligji, është paraparë se *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*.

Në bazë të lartcekurave gjykata ka ardhur në përfundim se është argumentuar fakti se i padituri nuk e ka përmbushur obligimin e tij lidhur me pagimin e të hollave sipas *kontratën për shitblerjen e traktorit të datës 06.05.2021*, dhe një fakt i tillë është vërtetuar në bazë të provave të lartcekura.

Andaj në bazë të gjendjes faktike të cekur më lartë dhe bazuar në dispozitën e nenit 8 dhe 245 të LMD-së, si dhe në dispozitën e nenit 143 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale gjykata është mbështetur në dispozitat e neneve 449 dhe 452 të LPK-së, ashtu që është i detyruar i padituri që të kompensoj shpenzimet që i referohen përfaqësuesit të palës paditëse dhe atë përpilimin e padisë shumë prej 104,00 €, taksë gjyqësore shumë prej 100,00 € euro, si dhe për një seancë në shumë prej 135,00 €.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC,
C.nr.1021/2021, më 02.06.2022**

**B. Profesional
Armond Qmega**

**Gjyqtari
Betim Behluli**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, ankesa paraqitet nëpërmjet të kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit, Divizioni Civil në Prishtinë.